



Thirrje për abstrakte

**“KONFERENCA E XI MJEKËSORE NDËRKOMBËTARE NË
SPECIALITETE”
XI-ICMS**



24,25,26 Nëntor 2025



Salla (120A), Fakulteti Shkencave Mjekësore
Teknike, Universiteti I Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Elbasan

Afati i dorëzimit të Abstraktit: **10 Gusht 2025**
Njoftimi mbi pranimin e abstraktit: **15 Shtator 2025**

Pas suksesit të dhjetë edicioneve, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, në bashkëpunim me Universitetin e L'Aquila dhe Universitetin e Barit, Itali, do të organizojë "Konferencë e XI Mjekësore Ndërkombëtare në Specialitete"-XI-ICMS, e cila do të zhvillohet në datat 24, 25, 26 Nëntor 2025. Kjo konferencë synon të ofrojë një platformë shkencore për shkëmbimin e përvojave klinike dhe kërkimeve bashkëkohore, nxitjen e bashkëpunimit akademik ndërkombëtar dhe promovimin e praktikave të bazuara në evidencë në fushat e ndryshme të shkencave mjekësore. Ftojme të gjithë profesionistët e shëndetësisë, studiuesit dhe studentët të paraqesin punimet e tyre kërkimore në fusha të ndryshme mjekësore, në tre ditët e Konferencës për një auditor të gjërë. Kjo konferencë është në proces akreditimi dhe të gjithë relatorët e pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata dhe kreditet përkatëse.

Detajet e dorëzimit:

- Afati i dorëzimit të Abstraktit: **10.08.2025**
- Ju lutemi dërgoni abstraktin tuaj në adresën e emailit <**konferenca.fshmt@uniel.edu.al**> me subjekt "**Dorëzimi i Abstraktit – Emri dhe Mbiemri juaj**".
- Aplikantët do të njoftohen mbi pranimin e abstraktit/ abstrakteve brenda **15 shtator 2025**
- Për më shumë informacion, ju lutemi na kontaktoni në <**konferenca.fshmt@uniel.edu.al**>.

Udhëzimet për abstrakt:

- Abstrakti nuk duhet të jetë më shumë se 300 fjalë.
- Titulli: Një titull konciz dhe përshkruues i studimit tuaj, pa shkurtime dhe initiale.
- Autorët: Listoni të gjithë autorët, duke përfshirë përkatësitë e tyre dhe emailin e autorit korrespondent.
- Hyrje/Sfondi: Një hyrje e shkurtër në temën e kërimit dhe rëndësinë e saj në fushën e shëndetësisë.
- Objektivat: Paraqitni qartë qëllimin dhe objektivat e studimit tuaj.
- Metodatat: Përshkruani metodologjinë e përdorur në studimin tuaj, duke përfshirë çdo teknikë ose qasje përkatëse.
- Rezultatet: Përmbledhni gjetjet kryesore të kërimit tuaj.
- Përfundime: Theksoni implikimet e gjetjeve tuaja dhe rëndësinë e tyre me praktikën ose politikat shëndetësore.
- Formatit: Abstraktet duhet të dorëzohen në formatin word, duke përdorur font standard Times New Roman, 12 pt., një hapësirë të vetme midis fjalëve dhe 1.0 hapësirën midis rreshtave.

- Ju lutemi shmangni citimet në abstrakt.
- Origjinaliteti: Të gjitha paraqitjet duhet të jenë punë origjinale dhe të mos jenë paraqitur më parë në konferenca të tjera ose të botuara në revista shkencore.

Procesi i rishikimit:

Të gjitha abstraktet e dorëzuara do t'i nënshtrohen një procesi të rishikimit nga Komiteti Shkencor i Konferencës. Kriteret për vlerësim do të përfshijnë origjinalitetin, lidhjen me fushën shëndetësore, metodologjinë dhe risitë e implikimet për kërkimin dhe praktikën mjekësore. Abstraktet e përzgjedhura do të ftohen për prezantime orale.

Me padurim presim kontributet tuaja dhe zhvillimin e një konference sa më interesante e frymëzuese!

Me respekt,
Komiteti Organizativ i XI- ICMS